

Data: 23.09.2014, 12:42

Vetëm në Shkup vitin e kaluar 53 aborte te adoleshentët prej moshës 15 deri në 19 vjeç



Është rritur numri i aborteve më të rijë se 20 vjet dhe te të miturat në vend dhe pavarësisht edukimit i cili zbatohet në shkollat fillore dhe të mesme dhe disponueshmëria e madhe e informacioneve në internet për tu mbrojtur nga shtatzënia e padëshirueshme, edhe me biseda me prindërit, kolegët, në revista të ndryshme, broshure dhe materiale të tjera në këto tema. Nëse në vitin 2008 janë regjistruar 146 aborte para moshës 20 vjet, në vitin 2013 sipas të dhënave nga Instituti i shëndeti publik, numri është rritur pothuajse 100 herë vitin e kaluar kaka pasur 237 ndërprerje të shtatzënisë të kjo popullatë. Në Qendrën e shëndetit publik Shkup tregojnë se të dinë shumë, mirëpo pakë praktikojnë! Vetëm në kryeqytet gjithsej 53 vajza të moshës 15 deri 19 vjet vitin e kaluar kanë vendosur të kryejnë abort.

Numri i aborteve është zvogëluar por jo edhe tek të rinjtë para moshës 20 vjeçe.

Numri i përgjithshëm i aborteve të regjistruar në vend filloi pak të zvogëlohet prej 5900 në vitin 2008 në 4983 në vitin 2013, por të dhënat alarmojnë se është një rritje e numrit të ndërprerjeve të shtatzënieve të të rinjtë para moshës 20 vjet dhe tek të miturat, tregon statistika zyrtare e Institutit për shëndet publik . vitin e kaluar në klinikën e gjinekologjisë nga gjithsej 196 aborte 5 aborte janë kryer nga të miturat. Prej janarit deri më tani ka pasur 191 ndërprerje të shtatzënisë nga të cilat pesë janë më të reja se 18 vjet. Sipas të dhënave nga Qendra e shëndetit publik Shkup në vitin 2013 janë regjistruar 53 aborte adoleshente prej moshës 15 deri 19 vjet. Vetëm në gjysmën e vitit janë mbajtur 627 ligjërata në Shkup dhe në fshatrat për rreth dhe janë organizuar pesë tribuna ku përmes diskutimeve me studentët i vlerësuam çfarë dinë për tu mbrojtur nga shtatzënia e padëshiruar dhe për sëmundjet seksuale të transmetuara dhe çka i mungon në ligjëratat shkurt thuhet, të rinjtë dinë shumë mirëpo praktikojnë pak kur bëhet fjala për shtatzëni të padëshiruar. Ato mendojnë se dinë se si të mbrohen, mirëpo nganjëherë ato nuk i kanë informacionet e duhura. Në ligjërata shpërndajmë broshura për kontracëpsionin dhe infeksionet seksualisht të transmetuara si dhe shpërndahet edhe prezervativ. Nga janari janë shpërndarë 1095 prezervativë tregon D-r Vesna Spirova udhëheqëse e repartit e mjekësisë sociale në Qendrën e shëndetit publik Shkup.

Prezervativët ndahen nga pedagogët

Ajo shpjegon se prezervativët kanë filluar ti shpërndajnë së pari në ligjërata sidomos në shkollat e mesme, kurë mjekët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit. Por ka pasur edhe reagime edhe është sugjeruar se më së miri është që këto mjete mbrojtëse të shpërndahen nga pedagogët dhe psikologët të cilët janë në kontakt më të shpeshtë me fëmijët. Sepse ka studentë të cilët nuk duan në ligjërata para të tjerëve të marrin prezervativë, sepse në çdo kohë mund të trokasin në derën e pedagogut. Të rinjtë duhen të janë të vetëdijshëm kur fillojnë të praktikojnë jetën seksuale, duhen të dinë se si të mbrohen nga infeksionet e transmetuara dhe nga shtatzënia e padëshiruar . qëllimi ynë final është për it informuar sa më shumë të rinjtë para se të fillojnë jetën seksuale të informohen për të gjitha rreziqet që i mban ky aktivitet dhe të trajnohen dhe të dinë si të mbrohen. Theksoj se aborti është metoda më e keqe për planifikimin familjarë, edhe kurë aborti është zgjidhja, atëherë më mirë është që të bëhet në mënyrë të sigurt . d.m.th në Institucione shëndetësore të specializuara e cila me cilësinë e shërbimeve të tyre e minimizon mundësinë e komplikimeve të hershme ose komplikimeve të vona në jetë në llojin e sterilitetit – D-r Vesna Spirova .

„ Axhibadem Sistina,, ndërhyrja të kryhet vetëm në spitale.

Sipas statistikës nga spitali Axhibadem Sistina,, 4 vitet e fundit numri i aborteve është në rritje. Megjithatë nga të dhënat statistikore është e vërtetë se ka një zvogëlim të numrit të aborteve por kjo sigurisht nuk është për shkak të përdorimit të kontraceptiv[s, por kjo është për shkak të kryerjes së intervenimeve të paligjshme dhe atë nga mjek gjinekolog në kushte të papërshtatshme. Ndërhyrja duhet të kryhet vetëm në spitale apo institucione të kujdesit shëndetësor sekonda apo terciar sepse këto institucione për ndërhyrje të abortit kanë dhoma operative dhe repart të transfuzionit , kështu që nëse ndodhë ndonjë komplikim do të zgjidhet men njëherë tregon D-d Gordana Petrovska specialist për gjinekologji dhe obstetrikë në Axhibadem Sistina. Pacienti më i ri në spitalin tonë ku u ndërprit shtatzënia ishte më e re se 16 vjet. Ajo erdhi me dokumentacion të nevojshëm , nënshkrim nga të dy prindërit, certifikatë të lindjes, pëlqim për abort të nënshkruar nga dy prindërit tregon d-r Gordana Petrovska.

marrë nga gazeta Dnevnik
gazetare: Lubica Ballaban